



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

“PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT ME FUNKSION HOTEL, 8 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE PARKIM
NËN TOKË “WAVE HOTEL”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS”

MIRATOHET
KRYETARI I K.T.

Z. EDERAMA



MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Z. BLENDI KLOSI



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 37, Datë 28.12.2020

Projektues:

ARK. KLEANT BIBOLLI LIC. A.1624

ARKITEKT
KLEANT BIBOLLI
NR. LIC. A1624

TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
 - 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
 - 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
 - 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë / vendparkimet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1. Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt me funksion hotel 8 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë “Wave Hotel”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, me zhvillues shoqeria “LTD Co” sh.p.k., bazuar në:

- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar nenit 7 dhe neni 28.
- Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

1.2. Përshkrim i zonës së studiuar

Territori në këtë studim gjendet në një aks të rëndësishëm të qytetit dhe në një hapësirë me tematika të ndryshme ku spikatin ato me funksion kryesish shërbime, restorante, hoteleri, etj. Ndërhyrja në këtë truall synon në plotësimin e kësaj hapësire nga pikpamja funksionale dhe njëkohësisht përmirëson imazhin urbano-arkitektonik të këtij aksi.

Kufizimet e sheshit të ndërtimit janë: Veri: Rrugë, Jug: Pedonale (plazh), Lindje: Pronë private dhe Objekt ekzistuese 4 kat, Perëndim: Rrugë ekzistuese, Distancat nga kufiri i pronës: Veriu 3.3m - 3.3m, Lindja 5.1m - 5.8m, Jugu 0.4m - 0.6m, Perëndimi 3.8m - 4.7m, Distancat nga aksi i rrugës: Veri: 5.6m, Perëndimi: 9.0m. Rruga kryesore e lidh sheshin me qendrën e Durrësit dhe zonën e plazhit. Ky shesh ndodhet në një nyje të rëndësishme komunikimi.

Në periudhën që pasoi ndryshimet e mëdha sociale dhe ekonomike të fillimviteve 90, kjo zonë pësoi një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme në fushën e ndërtimit që sollën si rezultat transformimin jo vetëm të thurjes urbane ekzistuese por edhe transformimin e tipologjisë dhe volumetrisë të gjithë zonës. Këto transformime, panvarësish se jo gjithmonë të suksesshme, i dhanë një dinamizëm të ri zonës duke rritur në mënyrë eksponenciale numrin e frekuentuesve të zonës, tipologjinë dhe numrin e shërbimeve të ofruara në këtë panoramë të re urbane të këtyre viteve.

Pas viteve 90 zona e fillimit te plazhit ne qytetin e Durrësit, u hap per zhvillim e gjere dhe u kthye në një hapësirë me rëndësi të vecantë sociale ekonomike. Zona mori një tjetër pamje dhe rëndësi. Në këtë zonë ndodhen mjaft godina hoteliere por jo pak edhe godina banimi dhe shërbime të ndryshme. etj. Aktualisht kjo zonë, është nga zonat më të preferuara për argëtim, për hoteleri, për zyra, për banim gjithashtu.



Fig. 1. Vendndodhja e pronës

2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

2.1. Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së

Bashkia Durrës ka Plan në fuqi sipas kufirit të vjetër administrativ, (neni 45 i VKM-së 408) nuk ka PPV të hartuar për zonën ku kërcohët të kryhet zhvillimi.

Projekt -Propozimi, ndodhet përgjatë brezit bregdetar, shpallur si zonë e Rëndësisë Kombëtare në planifikim, me Vendimin Nr. 1, date 14.06.2016 "Per miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit" si dhe në zonën me përparësi zhvillimin e turizmit.

Projekt – Propozimi ndodhet në Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, Vendimi Nr. 88, datë 01.03.1993 “Për Miratimin e Zonave që kanë Përparësi Zhvillimin e Turizmit”. Sipas PPV së propozuar projekt-propozimi ndodhet në nönnjësinë: S 9.4 Turistike & Tregetare.

3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese

Zona që do të zhvillohet ndodhet në zonen e plazhit të Durrësit. Prona e vënë në dispozicion për këtë leje ndërtimi është prona me nr. 3/21, zk. 8518, Durrës, në pronësi të Z. Ilir Shtufi, me sipërfaqe 660 m². Sheshi i ndërtimit është i kufizuar me 2 rrugë në pjesën lindore dhe veriore. Në pjesën jugore kufizohet nga një strukturë ekzistuese, ndërsa nëperëndim përballet me

plazhin dhe Detin Adriatik. Përpara sheshit të ndërtimit shtrihet shetitorja , e cila ndan plazhin nga zona urbane.

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1. Funksionet dhe aktivitetet e propozuara




Fig. 2. Skema e objektit ne altimetri




Fig. 3. Skema e peredorimit ne katet tip

KATI PERDHE




Fig. 4. Skema e peredorimit ne katin përdhe

KATI -1




Fig. 5. Skema e perdonimit ne katet nëntoke

Nga ana fukcionale kemi 2 kate nëntokë me funksion parkim dhe disa ambjente teknike të mewojshme për depozitat e ujit, kabinën elektrike si dhe sistemin e mbrojtejs nga zjarri, aksesi tek të cilat bëhet nga ana e rrugës në veri të sheshit të ndërtimit, nëpërmjet rrampës qe të çon në parkim. Kati përdhe ka funksion shërbimi si holl, recepcion, bar-restoran dhe kuzhina bashkë me nyjet sanitare. Ky kat ruan një formë tjetër gjeometrike nga ajo e kateve të mësipërm pasi është tentuar një shfrytëzim sa më i mirë i siperfaqes së disponueshme. Më siper ndodhen kate tip. 7 të tillë të cilët janë të organizuar me dhoma standarte dhe suita. Në cdo kat ka 6 dhoma hoteli, 1 dhomë teknike për mirëmbajten, një grup shkallësh që plotëson standartin si shkallë emergjencë si dhe 2 ashensorë për 8 deri 10 persona secili. Korridori i cili lidh të gjitha këto ambjente është i përmasave optimale dhe i ndricuar me drithë natyrale nga ana veriore. Kati do të jenë në formën e katit tip ku planimetritë përsëriten në cdo kat ndërsa ballkonet janë ato që ndryshojnë duke krijuar edhe ritmin e një fasade dinamike, gjë e cila bie në sy në këtë objekt.

4.2. Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave

Kompozimi i dhomave rreth bllokut të shkallë-ashensorit është një zgjidhje korrekte e imponuar nga gjeometria e godinës. Në kërkim të formës së objektit dhe duke respektuar kondicionet, konkludohet në një strukturë arkitektonike racionale me formë dhe thyerje të alternuara të volumit të shoqëruara me përdorimin e rifiniturave cilësore. Kjo zgjidhje jep një

efekt tē fortë arkitektonik si dhe e përafron me shembujt pozitivë të trendit të sotëm arkitekturor.


Kombinimi i kujdeshem i materjaleve veshës e shoqëruar me kompozimin e kujdeshem në trajtimin e fasadave, krijon një imazh pozitiv dhe me të perceptueshëm të godinës në kontekstin e gjerë urban tē këtij territori. Cilësia e materialeve të përdorura është maximale, po kështu edhe kualiteti i sistemeve elektrike, hidraulike apo elektronike. Dyert dhe dritaret e jashtme do të jenë duralumini dhe me ngjyrë të njëjtë në të gjithë godinën dhe me parametrat e caktuar për hotel. Fryma e përgjithshme e objektit është me elemente të stilit modern.

Volumetria

Objekti nga ana volumetrike është konceptuar si një volum i vetëm ku lojën arkitektonike e bëjnë ballkonet tē cilat shtrihen përgjatë perimetrit të godinës. Nëpermjet ballkoneve të cilat imitojnë valët e detit, objekti i përshtatet mjaft mirë kontekstit ku ndodhet dhe pikërisht prej këtyre ballkoneve ka marë edhe emrin Wave Hotel. Në volumetri dallohen qartë funksionet që ka godina ku kati përdhe është i dedikuar pér shërbime si :holl, restoran, bar, beach bar etj . Në katet e sipërme janë dhoma që përshkohen nga ballkonet në formë valësh tē cilat përvetësojnë arkitekturor u krijojnë frektuentuesve të hotelit mundësine pér të shijuar perendimin e tij. Gjithashtu pishina e vendosur në tarracë e trajtuar në stilin infinity pool, do tē krijojë efektin sikur shkrihet me detin gjë e cila e forcon impaktin arkitektonik të godinës.

Fasada

Kombinimi i kujdeshem i materjaleve veshëse shoqeruar me kompozimin e kujdeshem në trajtimin e fasadave, krijon një imazh pozitiv dhe më të perceptueshëm të godinës në kontekstin e gjerë urban tē këtij territori. Cilësia e materialeve të përdorura është e lartë. Është menduar një arkitekturë e qetë, e pastër, e stilit modern, e kombinuar me materiale luksoze si : xhami, veshja me mermer dhe elementet e metalit të trajtuar, po kështu edhe kualiteti i sistemeve elektrike, hidraulike apo elektronike.



Sarajevo: Povijest i predstave

Industria e società urbane

Por në këndvështrimin e gjerë urban të qytetit të Durrësit, kjo ndërtuesë lartëson natyrën dhe historinë e saj te ardhme. Ndërhyrja në këtë truall synon në plotësimin e kësaj hapësire nga përdorja funksionale dhe njëkohësisht përmireson imazhin urbano-arkitektonik të këtij aksi. Gjithashtu harmonizohet me simotrat e saj të ndërtuara rishtaz në zonë, por edhe shërben si një lindje apo si një standart i ri përcaktues në ndërtimet e tjera që do të pasojnë. Standarti i këtij vjetëm i qëndrimit në hotel por edhe i ndërtimit të një strukture hoteliere, është sot një nga këshuat kryesore në Shqipëri dhe si e tillë kjo kërkesë përmbyshet plotësisht në këtë qytet. Aflësia e këtij sheshi me hyrjen e Durrësit, me autostradën, gjithashu me portin e Durrësit, mundëson akses të gjithanshëm.

Gjatë kësaj përfundimtare e detit dhe bregdetit i ka dhënë strukturës formën e saj me ballkonet dinamike të formës valësh të cilat e bëjnë strukturën edhe një herë të shkrihet me mjeshtërin ku gjendet.





Fig. 789. Pamje e objektit të propozuar

4.3. Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	660 m ²
Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim:	660 m ²
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	433 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	3012.5 m ²
Koefiqenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	65 %
Koefiqenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike:	35 %
Intensiteti i ndërtimit:	4.56
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	31.99 m
Numri i kateve mbi tokë:	8 kat
Numri i kateve nën tokë:	2 kat

TREGUES TEKNIK:

Zona Kadestrale: Z.K. 8518; Nr. pasurie 3/21, në emër të: Z. Ilir Shtufi.

Kufinimet:

Veri: Rrugë

Jug: Pedonale (plazh)

Lindje: Pronë private dhe Objekt ekzistuese 4 kat

Perëndimi: Rrugë ekzistuese

Distancat nga kufiri i pronës: Veriu 2.1m - 2.1m, Lindja 5.5m - 5.9m, Jugu 1.5m - 3.0m, Perëndimi 0.7m.

Distancat nga aksi i rrugës: Veri: 5.6m, Perëndimi: 5.5m.

Pronar trualli: Z. Ilir Shtufi

Zhvillues: "LTD Co" sh.p.k.

Subjekti Ndërtues: "LTD Co" sh.p.k.

4.4. Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet

Hapësirat me të përqark objektit, janë brenda normave për garantimin e një qarkullimi normal të këmbësoreve dhe për të siguruar akses në raste emergjencash. Ato gjithashtu janë menduar që të janë njëkohësisht dhe të gjelbërta mjaftueshëm për t'u përdorur si hapësira çlodhëse, siç përfshinë hapësira te tillë. Parkimet janë tërësisht nëntokësore.

5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

5.1. Posisionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Ky projekt prezanton edhe një propozim për zgjerimin dhe permiresimin e infrastrukturës rrugore. Respekton plotësisht gjendjen ekzistuese, dhë propozon zgjerimin, permiresimin e saj si dhe intensitetin i levizjes ne zone menjohet të jetë në rritje dhe si i tillë përmirësimi i

infrastrukture publike , edhe pse një zonë e formuar , do të krijojë komoditet dhe standart më të lartë aksesi dhe lëvizshmëri.

Objekti do të zhvillohet në truallin e vet. Sheshi i ndertimit është i kufizuar me 2 rrugë në pjesen lindore dhe veriore. Përpara sheshit të ndërtimit shtrihet shëtitorja , e cila ndan plazhin nga zona urbane. Në anën lindore drejt për drejt nga rruga ekzistuese realizohet edhe hyrja në parkimin nëntokësor.



Fig.2. Planimetria e strukturës që propozohet